

NË EMER TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi, kryetar, Fillim Skoro, gjyqtar referues, e Have Haliti, anëtare, me bashkëpunëtoren profesionale Leonita Lajçi, si procesmbajtëse, në lëndën penale të akuzuarit Q.B. nga Peja, për shkak të veprës penale vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, av. H.Ç., të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Pejë, P.nr.69/2017, të dt. 08.09.2017, në seancën publike të kolegjit të mbajtur me dt.11.12.2017, morri këtë:

AKTGJYKIM

Refuzohet ankesa e mbrojtësit të akuzuarit Q.B. av. H.Ç., dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore- DKR në Pejë, P.nr.69/2017, të dt. 08.09.2017, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore-DKR në Pejë, P.nr.69/2017, të dt. 08.09.2017, i akuzuari Q.B., është shpallur fajtor për veprën penale vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, dhe është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej datës prej dt. 25.05.2017 e gjerë me dt. 05.09.2017.

Nga i akuzuari është konfiskuar thika e kuzhinës dhe kaçavida, si mjete me të cilat është kryer vepra penale.

I akuzuari është obliguar që në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 50 €, si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajë shumën prej 50 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij, aktgjykimi me kohë ka ushtruar ankesë:

-Mbrojtësi i të akuzuarit Q.B., av. H.Ç., lidhur me vendimin mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovojë ankesën dhe të akuzuarit t'i shqiptojë dënim më të butë.

-Prokuroria e Apelit, me shkresën e saj PPA/I.nr.436/2017, të dt. 16.07.2017, duke u sqaruar përkitazi me ankesat e mbrojtësit të akuzuarit Q.B., av. H.Ç., ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, caktoi seancën e kolegjit, konformë nenit 390 par.1 të KPP, në të cilën nuk morën pjesë Prokuroria e Apelit-DKR në Prishtinë, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij H.Ç., edhe pse ishin të njoftuar në mënyrë të rregullt dhe seanca e kolegjit është mbajtur në mungesë të tyre, për arsye se pjesëmarrja e tyre nuk është e domosdoshme, ndërsa Prokuroria e Apelit, në mendimin e saj me shkrim ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar sipas pretendimeve ankimore të mbrojtësit të akuzuarit Q.B., av. H.Ç., edhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPP, e duke marrë parasysh edhe sqarimin e Prokurorisë së Apelit-DKR në Prishtinë, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave tjera të lëndës, gjeti se:

Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit Q.B., av. H.Ç., refuzohet si e pabazuar.

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e gjykatës.

Mbrojtësi i të akuzuarit Q.B., në ankesën e tij pretendon , se gjykata i ka trajtuar rrethanat lehtësuese kur është vendosur me rastin e matjes së dënimit, mirëpo edhe përkundër kësaj, të akuzuarit i ka shqiptuar dënim shumë të rëndë bazuar në gjendjen shëndetësore të tij. Gjykata ka vlerësuar rrethanat lehtësuese pranimin e fajësisë, deklarimin e babait të dëmtuarit, se familjet e tyre janë pajtuar dhe se janë familjarisht janë të lidhur dhe nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale. Gjykata nuk ka vlerësuar drejtë se i akuzuari Q.B., është baba i fëmijëve të mitur, se i njëjti lëngon nga sëmundja e epilepsisë, se që nga vitit 1992 e që vërtetohet nga raporti mjekësor ku i njëjti është diagnostikuar me sëmundjen e epilepsisë, Disordines, Anksio-Reaktiva (ad, situationen), ndërsa gjykata rrethana rënduese në këtë çështje penale nuk ka gjetur.

Gjykata e Apelit, në pajtim me nenin 394 par.1 të KPP, duke e shqyrtuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, e sipas detyrës zyrtare në kuptim të ekzistimit të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1 dhe shkeljes së ligjit penal, nga neni 385 par.1 të KPP, Gjykata e Apelit, gjen se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është përfshirë në shkeljet e cekura më lartë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Gjykata e Apelit, duke e vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, përkitazi me vendimin mbi dënimin, e sipas pretendimeve ankimore të paraqitura nga ana e mbrojtësi i të akuzuarit, gjen se pretendimet të paraqitura në ankesë e të cilat janë cekur më lartë, janë të pabazuara. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese të cilat shkojnë në dobi të akuzuarit , pranimin e fajësisë, deklarimin e babait të dëmtuarit se ata janë pajtuar dhe se janë në farefisni, se i dëmtuari nuk i është bashkëngjitur veprës penale, si dhe ka marrë parasysh gjendjen shëndetësore të akuzuarit dhe të gjitha këto rrethana Gjykata e Apelit, i merr si të vërtetuara.

Pretendimi kryesor i mbrojtësit të akuzuarit se i Akuzuari vuan nga sëmundja e epilepsisë, Disordines, Anksio-Reaktiva (ad, situationen) është i pabazuar, për arsye që natyra e sëmundjes së epilepsisë, nuk mund të trajtohet si rrethanë lehtësuese dhe ajo përjashton përgjegjësinë penale juridike të akuzuarit në momentin e kryerjes së veprës penale. Kjo nënkupton se i akuzuari në momentin kur është kryer vepra penale, të ishte në gjendje të sulmit të epilepsisë atëherë ai do të ishte i pallogaritshëm, dhe në prezencën e këtyre rrethanave siç rezulton nga shkresat e lëndës i akuzuari veprën penale nuk e ka kryer në momentin e sulmit nga epilepsia, dhe për këtë arsye pretendimi ankimor i mbrojtësit të akuzuarit është tërësisht i pabazuar. Dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, e në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak, është në proporcion me peshën e veprës penale dhe vlerën e mbrojtur për arsye jeta dhe trupi i njeriut, është vlerë më e madhe e mbrojtjes penale-juridike dhe me dënimin e shqiptuar të akuzuarit, pritet që të parandalohet të akuzuarin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëhet rehabilitimi i tij, si dhe të përmbahen edhe personat tjerë nga kryerja e veprave penale të natyrës së këtillë dhe se me dënimin e këtillë të shqiptuar pritet të arrihet preventiva individuale dhe ajo e përgjithshme si dhe qëllimi i dënimit i paraparë si në dispozitën e nenit 41 të KPRK.

Nga arsyet e sipër cekura më lartë, ankesa e mbrojtësit të akuzuarit u deshtë të refuzohen si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet e në bazë të nenit 401 të KPP.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.464/2017, me dt.11.12.2017

Procesmbajtëse,

Leonita Lajçi

Anëtarët e kolegjit,

Fillim Skoro

Have Haliti

Kryetari i kolegjit,

Xhevdet Abazi